




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK
Dep.	03
nr. fajl	
broj stranica	
Nr. pages	
N. Prot.	01-3446/14
B. prot.	
Prot No	
Data	
Datum	03.10.2014
Date	
BRUJUE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.10.2014 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me nr. AKK -03-2168/14, për z. Refki Gega - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Therandës (Suharekës), dhe njëkohësisht Avokat i Regjistruar në Oden e Avokatëve të Kosovës.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

IV. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), si dhe ne bazë të vendimit Nr. 03-2168/14 është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për zyrtarin e lartë, z. Refki Gega – Kryesues i Kuvendit në Komunën e Therandës (Suharekës), i cili njëkohësisht ushtron edhe funksionin e Avokatit.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interest (AKK-DPK-01-2537/14), pas pranimit të kësaj shkresë, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është njoftuar për situatën mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhet.

Në këtë takim, zyrtarit të lartë z. Gega, i është bërë e ditur se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksionin e Avokatit. Kjo për faktin se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) e ndalon një gjë të tillë. Neni 16 (paragrafi 2) i këtij ligji shprehimisht thotë:

“Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrin 1. të këtij nenit”.

Zyrtari i lartë z. Gega, ka caktuar një person të autorizuar për të menaxhuar Avokaturën e tij, mirëpo nuk ka pranuar ta bëjë pezullimin e funksionit të Avokatit në Oden e Avokatëve të Kosovës.

Përkundër afateve ligjore të dhëna nga Agjencia, duke përfshirë edhe shkresë paralajmëruese (AKK-01-2977/14), zyrtari i lartë nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të pezulluar funksionin e Avokatit në Oden e Avokatëve të Kosovës, dhe për të shmangur konfliktin e interesit.

Agjencia kë bërë kërkesë edhe në Oden e Avokatëve të Kosovës për t'u informuar nëse z. Refki Gega ka bërë kërkesë për inicimin e procedurës për pezullimin e funksionit të avokatit, mirëpo Oda e Avokatëve të Kosovës kanë kthyer përgjigje se nuk është iniciuar ndonjë procedurë e tillë.

Prandaj, duke pasur parasysh këto rrethana, vlerësojmë se zyrtari i lartë nuk e ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Bazuar në nenin 18 (paragrafi 8) të Ligjit (Nr.04/L-051), në rast se zyrtari i lartë vazhdon të kryej aktivitete apo funksione të papajtueshme sipas këtij ligji, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë, atëherë Agjencia i kërkon institucionit ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrin 1.1, 1.2 dhe 1.3.

Sipas nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtari i lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund ti shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit”.

IV. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

IV. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ zpj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

